

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses L. P., nga Peja, tani me banim të përkohshëm në Kotor, Republika e Malit të Zi, kundër të paditurve Komuna e Pejës, Qeveria e Republikës së Kosovës në Prishtinë, UNMIK-u dhe KFOR-i, Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizionit të paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4229/2015 datë 7.07.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.06. 2017, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditëses i paraqitur kundër pjesës së II-të të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4229/2015 datë 7.07.2016.

#### A r s y e t i m i

Me pjesën e II të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4229/15 dt.7.07.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.2689/04 dt.2.07.2013, me të cilin është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses, kundër të paditurve Komuna e Pejës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës që të detyrohen , që paditëses t'i kompensojnë dëmin material në shumë të tërësishme prej 184.000,00-€ me kamatë ligjore nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe atë për kompensimin e objekteve ndërtimore në shumë prej 128.000,00-€,për kompensimin e dëmit për shkatërrimin e sendeve të luajtshme 20.000-€,fitimit

të humbur 30.000-€, shpenzimet e zhvendosjes-akomodimit 6000-€ si dhe të paguajnë shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ndërsa, e ka hedhur si të palejuar padinë e paditëses, kundër të paditurve UNMIK dhe KFOR, për kompensimin e dëmit dhe ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër pjesës së II të dispozitivit aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësja ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni, që aktgjykimet e instancave më të ulëta të prishen, ndërsa, lënda të kthehet në rivendosje ose të ndryshohen dhe të miratohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit në pjesën e goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i paditëses është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja ka ngrit padi kundër të paditurve për shkak të kompensimit të dëmit material në shumë të tërësishme prej 184.000,00-€, të shkaktuar në pasurinë e paditëses, në objektin-lokalin afarist në ngastrën kadastrale nr..., në rrugën ..., -Pejë, pas hyrjes së forcave të KFOR-it në Kosovë (pas 10.06.1999), për çfarë pretendon se përgjegjës për dëmin e shkaktuar material është Komuna e Pejës, Qeveria e Kosovës, KFOR-i dhe UNMIK-u me seli në Prishtinë.

Gjykata e shkallës së parë, në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, ka gjetur se është e pabazuar kërkesëpadia e paditëses, sepse, të paditurit nuk janë përgjegjës për dëmin të cilin paditësja thekson se e ka pësuar, nga fakti se në kohën kur është bërë dëmi çështja e sigurimit, rendit dhe qetësisë publike ka qenë nën mbikëqyrjen e KFOR-it dhe UNMIK-ut.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të LPK-së, të pretenduara nga revizioni. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale, nuk mund t'i vejnë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët përkitazi me refuzimin e kërkesës së paditëses, pasi që janë dhënë arsyet bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, të pathemelta janë thëniet në revizionin e paditëses lidhur me atë se aktgjykimi i goditur është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Përkitazi me këtë, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses për kompensimin e dëmit material. Qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta edhe kjo gjykatë e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm pasi që të paditurat Komuna e Pejës dhe Qeveria e Kosovës nuk mund të jenë përgjegjëse për dëmin që ka pësuar paditësja në pronën e vet, në mungesë të legjitimitetit real pasiv të të paditurve. Kjo për faktin sepse të paditurit e sipër cekur nuk kanë qenë përgjegjës për sigurimin në Kosovë në kohën kur paditëses i është shkaktuar dëmi në pasurinë e saj. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1991/1 për Administrimin Civilë në Kosovë, ka qenë përgjegjëse Administrata e UNMIK-ut dhe se Komuna e Pejës(dhe jo vetëm ajo) si subjekt juridik është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/43 dt.27.07.2000, ndërsa, Qeveria e Kosovës ka filluar të funksionojë si subjekt vetëm pas zgjedhjeve të v.2001 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/19 dt.13.09.2001.

Me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr.1244 e miratuar me 10.06.1999, me autorizimin e Shteteve anëtare dhe Organizatave ndërkombëtare është vendosur prania ndërkombëtare në Kosovë(pika 7). Në par.9 pika d) të kësaj Rezolute është vendosur që

përgjegjësinë e pranisë Ndërkombëtare të Sigurisë që do të vendosen dhe veprojnë në Kosovë lidhur me garantimin dhe sigurimin publik derisa prania ndërkombëtare do të merr përgjegjësinë për këtë detyrë. Në bazë të autorizimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe me ndihmën e organeve tjera relevante ndërkombëtare është krijuar një prani civile ndërkombëtare në Kosovë, në mënyrë që të vendoset një administrim i përkohshëm në Kosovë dhe një administrim kalimtar me zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Me nenin 8 pika (a) të Kornizës Kushtetuese të Kosovës është paraparë se çështja e sigurimit publik është kompetencë e rezervuar nga Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara dhe përgjegjësinë e ka KFOR-i dhe UNMIK-u. Po ashtu, edhe në marrëveshjen teknike ushtarake të Kumanovës (që është pjesë përbërëse e Rezolutës 1244), është përcaktuar (neni 1 dhe 2), që përgjegjësinë për sigurimin dhe administrimin civil do ta marrin Kombet e Bashkuara dhe KFOR-i si forcë e sigurisë në Kosovë. Në mbështetje të të dhënave të argumentuara rezulton se në kohën kur paditëses i është shkaktuar dëmi material në pronën e saj përgjegjësia për sigurimin publik dhe administrimin civil nuk ka qenë e të paditurave Komunës së Pejës përkatësisht Qeverisë së Kosovës, e për rrjedhojë ato nuk kanë as obligim dhe përgjegjësi për kompensimin e dëmit material.

Nuk qëndron as pretendimi i revizionit përkitazi me hedhjen e padisë së paditëses ndaj të paditurve KFOR dhe UNMIK, nga se kjo gjykatë vlerëson se është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i gjykatave të instancës më të ulët, për arsye se në bazë të nenit 2.4 pika a) lidhur me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2000/47 dt.18.08.2000 për Statusin, dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe Personelit të tyre, ata janë të liruar nga jurisdikcioni vendorë, përkatësisht para gjykatave në Kosovë në lidhje me çfarëdo veprimi administrativ, civil apo kriminal, të kryer në territorin e Kosovës.

Gjithashtu, kjo Gjykatë vlerëson se nuk qëndron pretendimi vijues i revizionit lidhur me shkeljen e parimit "audiatur et altera pars-ndëgjimit edhe të palës tjetër), për faktin sepse gjykata e shkallës së parë në rastin konkret juridiko-civil ka vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 399.1 dhe 2 të LPK-së. Me këto dispozita parashihet se gjykata pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të

jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Përkatësisht, kërkesëpadia është e pathemeltë në vështrim të par.1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi apo po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi apo me faktet që janë botërisht të ditura, sikundër edhe është rasti konkret.

Për arsyet e sipërpërmendura revizioni i paditëses u refuzua si i pathemeltë, ndaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.120/2017 datë 13.06. 2017

Kryetar i kolegjit,  
Mr.sc. Muhamet Rexha